

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MAJLINDA L. BEGAJ

DATE 07/12/2021  
NR REP 1634



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 07 DEL 2021, para meje Notere MAJLINDA L. BEGAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BLV"BAJRAM CURRI", ND.170, H.24, AP.1, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

**Ilirjan Shkrela**, atësia Xhemal, amësia Elheme, shtetas Shqiptar, lindur në Rreth, Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Mihal Grameno; Nd. 1; H. 7; Ap. 27; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 23/02/1975, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032530401 dhe nr. personal H50223028E, .

Subjekti i mesiperm ne cilesine e perfaqesuesit ligjor me prokure te redaktuar ne Turqi me nr.032281 date 26/11/2021, me Noter Gulten DUMAN Zyra e noterise 71 Ankara, e mesipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkroi përpara meje Noteres Majlinda Begaj, "Aktine themelimit dhe Statutin e shoqerise SEA PAC ENGINEERING shpk", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

MAJLINDA L. BEGAJ



## AKTI I THEMELIMIT

### I

#### SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “SEA PAC ENGINEERING” SH.P.K.

Themeluesit qe nenshkruan me poshte si vijon:

- 1) **BURÇIN ERKAN**, shtetas turk, i datelindjes 10.05.1974, lindur ne Erzurum, Turqi dhe banues ne Turqi, mbajtes i Pasaportes me nr. U23368309, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, perfaqesuar nga Z.Illirjan SHKRELA, sipas Prokures me Nr.03281, Date 26.11.2021, redaktuar nga GULTEN DUMAN, Noteri me Nr. 71, Ankara, Turqi.
- 2) **BERKAY ŞEŞEN**, shtetas turk, i datelindjes 08.06.1978, lindur ne Samsun, Turqi dhe banues ne Turqi, mbajtes i Pasaportes me nr. S20040791, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, perfaqesuar nga Z.Illirjan SHKRELA, sipas Prokures me Nr.03281, Date 26.11.2021, redaktuar nga GULTEN DUMAN, Noteri me Nr. 71, Ankara, Turqi.

Qe ne vijim do te quhen Ortaket e Shoqerise “SEA PAC ENGINEERING” SH.P.K.

Sot me date 06.12.2021, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

### Kreu I

#### OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

##### Neni 1

##### Objekti i shoqerise

Shoqeria “SEA PAC ENGINEERING” SH.P.K., ka si objekt veprimtarie:

1. Sherbime ne Fushen e Ndertimit, Arkitektures, Tregtise, Import – Eksport.

##### Neni 2

##### Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

1. Ortaket vendosen qe shoqerine t’a emertojne “SEA PAC ENGINEERING” SH.P.K.
2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. Mustafa Lleshi, Pallati Luga, pasuria nr.3-1033/N:19, Tirane / Shqiperi.
3. Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, dege, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.



### **Neni 3**

#### **Forma Juridike**

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.
2. Me vendim te ortakeve mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4**

##### **Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve**

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

#### **Neni 5**

##### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

**Kreu III**  
**KAPITALI THEMELTAR**

**Neni 6**

**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000 (njqind mije) Leke**, dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota.

**Ortake te shoqerise jane:**

- 1) **BURCIN ERKAN**, zotërues i **1 (nje) kuote** me vlere **50.000 (pesedhete mije) Leke**, qe perben **50 %**, të kapitalit të shoqërisë.
- 2) **BERKAY ŞEŞEN**, zotërues i **1 (nje) kuote** me vlere **50.000 (pesedhete mije) Leke**, qe perben **50 %**, të kapitalit të shoqërisë.

**Kreu IV**  
**PERSONALITETI JURIDIK**

**Neni 7**

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit ne Tirane, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

**Kreu V**  
**ADMINISTRIMI**

**Neni 8**

1. Shoqeria do te administrohet nga administratori **Z. BERKAY ŞEŞEN**, i cili do te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **3 (tre) vjecare** dhe me te drejte rizgjedhje.
2. Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

**Kreu VI**  
**DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 9**

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakeve te saj.
2. Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.

3. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

*Autorizohet Denis Muka, i biri i Ilias, i datelindjes 06.01.1989, banuese ne Tirane, qe te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme prane Qendres Kombetare te Biznesit, per pergatitjen e dokumentacionit te nevojshem, aplikimin per regjistrimin e shoqerise dhe depozitimin apo terheqjen e cdo dokumentacioni te nevojshem te saj.*



### ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**BURÇIN ERKAN**

Perfaqesuar me Prokure nga

**Z. Ilirjan SHKRELA**

**BERKAY ŞEŞEN**

Perfaqesuar me Prokure nga

**Z. Ilirjan SHKRELA**

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“SEA PAC ENGINEERING” SH.P.K.**

**KREU I PARE**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Formimi i Shoqerise**

**NENI 1**

1. Shoqeria Tregtare “Sea Pac Engineering” SH.P.K., me seli qendrore ne adresen: Rr. Mustafa Lleshi, Pallati Luga, pasuria nr.3-1033/N:19, Tirane / Shqiperi, krijohet me date 06.12.2021, nga ortaket themelues **Z.BURÇIN ERKAN** dhe **Z.BERKAY ŞEŞEN**, Perfaqesuar te dy nga Z.Ilirjan SHKRELA, sipas Prokures me Nr. 03281, Date 26.11.2021, redaktuar nga GULTEN DUMAN, Noteri me Nr. 71, Ankara, Turqi.
2. Te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, si dhe Aktin e Themelimit, kane vendosur te destinojne ne kete Sipermarrje kapitalin e tyre, me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria e Shoqerise, si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne Kapitalin Themeltar.
3. Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire. Shoqeria tregtare “SEA PAC ENGINEERING” SH.P.K., fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit te saj prane zyres se Qendres Kombetare te Biznesit, Tirane.

**Forma, Emertimi,**

**NENI 2**

1. Shoqeria tregtare, eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar.
2. Emertimi i Shoqerise eshte: “SEA PAC ENGINEERING” SH.P.K.
3. Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare, mund te ruhet i njejti emertim, me kusht qe Personi Juridik te shtoje ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.

## **Selia, Territori**

### **NENI 3**

1. Shoqeria tregtare "SEA PAC ENGINEERING" SH.P.K., ka seline qendrore ne territorin e Republikes se Shqiperise ne adresen: Rr. Mustafa Lleshi, Pallati Luga, pasuria nr.3-1033/N:19, Tirane.
2. Shoqeria mund te krijoj qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi apo agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.
3. Ajo mund te jete pjesemarrse ne nje shoqeri tregtare apo mund te kontrolloje shoqeri te tjera tregtare si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
4. Njesite strukturore te shoqerise ne format e mesiperme do te krijohen ne perputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit te Republikes se Shqiperise, dhe jashte saj ne perputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendren e vet.
5. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## **Kohezgjatja**

### **NENI 4**

1. Shoqeria Tregtare "SEA PAC ENGINEERING" SH.P.K., do te permbushe objektin e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqerise duke perfshire edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje Personaliteti Juridik te ri.

## **Objekti**

### **NENI 5**

Shoqeria "SEA PAC ENGINEERING" SH.P.K., ka si objekt veprimtarie:

1. Sherbime ne Fushen e Ndertimit, Arkitektures, Tregtise, Import – Eksport.

### **NENI 6**

Shoqeria tregtare "SEA PAC ENGINEERING" SH.P.K., nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj.



## **Kapitali**

### **NENI 7**

#### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000 (njqind mije) Leke**, dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota.

#### **Ortake te shoqerise jane:**

- 1) **BURÇIN ERKAN**, zotërues i **1 (nje) kuote** me vlere **50.000 (pesedhete mije) Leke**, qe perben **50 %**, të kapitalit të shoqërisë.
- 2) **BERKAY ŞEŞEN**, zotërues i **1 (nje) kuote** me vlere **50.000 (pesedhete mije) Leke**, qe perben **50 %**, të kapitalit të shoqërisë.

### **NENI 8**

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta te financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.

### **NENI 9**

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi e rregullimi i çdo fondi te veçante percaktohen nga Ortaket sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e pergjitheshme te shoqerise dhe ne pergjithesi çdo operacion financiar i saj do te pasqyrohet ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.
3. Te ardhurat neto qe do te rezultojne nga bilanci i miratuar nga Vendimi i Ortakeve do te shperndahen si vijon: 5 % per fondin rezerve, deri sa ky fond te arrije 1/5 e kapitalit themeltar; ndersa pjesa tjeter ortakeve te saj.

### **NENI 10**

1. Shoqeria Tregtare "SEA PAC ENGINEERING" SH.P.K., eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.





3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

#### NENI 11

1. Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta te hartuara nga Ortaket dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim te Ortakeve te saj.

#### NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

#### NENI 13

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

#### NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e Ortakeve.

#### NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributeve ne para dhe ne natyre apo zvogelimi i tij behet me Vendimin e Ortakeve te shoqerise mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar.



## KREU I DYTE

### Ortakeria

#### NENI 16

Ortakët e shoqërisë tregëtare “SEA PAC ENGINEERING” SH.P.K., gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin pjesë për detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë.

### Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve

#### NENI 17

1. Të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakeve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

## KREU I TRETE

### Administrimi i Shoqërisë


#### NENI 18

1. Shoqëria do të administrohet nga administratori **Z. BERKAY ŞEŞEN**, i cili do të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet për një periudhë **3 (tre)** vjetore dhe me të drejtë rizgjedhje.
2. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.

### Asambleja

#### NENI 19

1. Asambleja e Ortakeve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzole e kundërt është e pavlefshme në këto rast.



## NENI 20

Asambleja e Ortakeve ka te drejte :

1. Te hartoje e miratoje ndryshimet ne Statut;
2. Te miratoje bilancin vjetor te shoqerise;
3. Te vendose per zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;
4. Te emeroje dhe shkarkoje administratorin e shoqerise;
5. Te shpalle prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqerise;
6. Te shprehet per kohezgjatjen e shoqerise;
7. Te miratoje marreveshjet arritura ne qarkullimin civil te saj;
8. Te miratoje strukturat e shoqerise etj.;
9. Çdo vendim tjetër qe i njihet nga ligji, Akti i Themelimit te shoqerise dhe Statutit te saj.

Proces verbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

## Te drejtat e Administratorit

### NENI 21

Administratori ka keto te drejta:

1. Te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet e saj me te tretet, ne administraten publike e ne organet gjyqesore;
2. Te emeroje prane shoqerise personelin e domosdoshem qe i nevojitet asaj ne permbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Te paraqese per miratim ne Asamblene e Ortakeve strukturen e brendshme organizative te shoqerise me emra perkates dhe te permbushe te gjitha detyrimet ligjore qe rrjedhin nga legjislacioni i punes Republikes se Shqiperise;
4. Te administroje pasurine dhe mjetet financiare te shoqerise brenda kufijve te caktuara nga Asambleja e Ortakeve;
5. Te testoje aftesite e punonjesve ne administrate;
6. Te therrase Asamblene e Ortakeve dhe te propozoje çeshtjet qe duhen analizuar;
7. Te hartoje objektivat e shoqerise per çdo vit pasues dhe te vendose e te ndjeke realizimin e detyrave te lena nga Vendimet e marra nga Ortaket;
8. Te hartoje planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqese ato per miratim nga Asambleja e Ortakeve.



## NENI 22

Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

## NENI 23

1. Shoqeria "SEA PAC ENGINEERING" SH.P.K., emeron Ekspert Kontabel te Autorizuar.
2. Per emerimin, kompetencat, detyrimet, pergjegjesite, zevendesueshmerine, terheqjen, shkarkimin dhe shperblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

## Marredheniet e Punesimit

### NENI 24

1. Te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi i tyre do te behet mbi bazen e kontrates individuale apo kolektive, sipas rastit, ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne kete fushe.
2. Marrja ne pune behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne Librin e Punes se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e Punes se Juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqeria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes, behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes per shkak te shkeljeve disiplinore ose me kerkesen e te interesuarit.
4. Mosmareveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim te paleve, te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfaqesues me prokure. Kur mirekuptimi nuk eshte i mundur, palet i drejtohen Gjykates te Rrethit Gjyqesor.

## DISPOZITA TE FUNDIT

### NENI 25

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do te aplikohet Ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe Legjislacioni Shqiptar ne fuqi.



**NENI 26**

Ky Statut hyn ne fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë.

**NENI 27**

Ky Statut përfshihet me 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njeri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKET E SHOQËRISË**

**BURÇIN ERKAN**

Perfaqësuar me Prokurë nga

  
**Z. Ilirjan SHKRELA**



**BERKAY ŞEŞEN**

Perfaqësuar me Prokurë nga

  
**Z. Ilirjan SHKRELA**

